

ILIR SHAQIRI

**ITH**

---

BOTIMET TOENA



ILIR SHAQIRI

ITH

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2019

Botuese: Irena Toçi

Recensues: Prof. Zef Kakoca

Redaktor: Mr.sc. Arben Veselaj

Korrektore letrare: Aurora Kenga

Ballina: Dr. Zeni Ballazhi

ISBN 978-9928-277-64-0

© Autori

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjete apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

**BOTIMET TOENA**

Rr. "M. Gjollësia", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: [redaksia@toena.com.al](mailto:redaksia@toena.com.al)

[botimet.toena@gmail.com](mailto:botimet.toena@gmail.com)

[www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

*... Poezia është trajnimi i shpirtit, metoda e  
përditësuar e lirisë së brendshme që përpiqet ta bëjë  
botën të ngjajë me ndjesitë e saj!*

*Diçka në mes të së djeshmes, të sotmes e të  
ardhmes.*



## PARAFJALË

### ILIR SHAQIRI POETI I SHPIRTIT

Nuk është e thjeshtë të flasësh për Ilir Shaqirin si poet dhe as të analizosh poezinë e tij. Pasi po përpiqemi të hyjmë në shpirt dhe të hulumtojmë brendësinë e tij, të ndërtojmë lidhje mes kuptimit dhe botës, në një dimension pa kohë ku vlerat e asaj çfarë është materiale lundrojnë në thellësitë e të paimagjinushmes.

Vepra e Shaqirit është rrëfim, prozë, ese, është e lidhur me hulumtime historike, njohuri letrare, estetike, shkencore, metodologjike, me eksplorime të shumanshme, dhe në të gjithë këtë gjejmë poezinë, pasi ajo buron nga zhvillimi natyror i vargut, degëzohet përmes frazave dhe nënkupton rrënjë në lëvizje, ajo lëvizje rrënjësore e ndërgjegjes që në momentin e parë të shqetëson e turbullon dhe më pas ti e tejkalon dhe të ndriçon.

Poetika e Ilir Shaqirit është *trajnimi i shpirtit*, dhe shpirti është i paprekshëm, i pacenueshëm, i pashpjegueshëm në pjekurinë e tij.

Illir Shaqiri, kantautor, shkrimtar, romancier është në thelb një poet. Në gjithësinë e tij. Në jetë dhe në art.

Përmes kësaj vepre, me titull sugestionues “ITH”, i shtyrë nga një “zjarrmi dashurie” të pafrenueshme, ashtu si vetë ai e përkufizon atë çfarë rrjedh në dejtë e tij, na dhuron një lirikë me fjalë shumëngjyrëshe, që lulëzojnë dhe kthehen në burime tregimesh, lumenj kujtimesh, puhiza verore, flutura të jetës në sekondën që merr arratinë dhe gdhendet në përjetësi në shkëmbin e ekzistencës njerëzore.

*Si puhizë verore  
mbi krahët e një fluturë  
situr përvetohet  
etshëm dashuria,  
përpushëm ngjyroset  
me ata sytë e tua,  
hojëz lirikë latore  
e venave të mia!*

Poeti bëhet hulumtues i shpirtit, mbledhës i kujtimeve dhe nisat në kërkim të ndjesive në vendet më të paimagjinueshme, si një Uliks i palodhur, por që nuk e humbet asnjëherë busullën e shtëpisë, udhëton nëpër botë, përthith emocione dhe kthehet po aty nga ku është



nisur, si një dallëndyshe që nuk e harron kurrë folenë e saj. Por ju do të pyesni, çfarë mbledh ai? I mbyllur në heshtjen e një cigareje që nuk mbaron, ndërsa ndan sekonda mendimesh dhe tinguj; mbush kanistrën e mendjes me pjesëza, me copëza të vogla jete, për të ndërtuar mozaikun e ekzistencës; mbush shpirtin dhe e ndan me të tjerët, nga mikrokozmosi i tij identitar deri në bashkësinë ku jeton, e më tej në ingranazhet herë të kënaqshme, herë festive e herë të dhimbshme të shoqërisë.

Harmonia e qenies kthehet në këngë, ritëm, melodi, lirikë, elemente, që autori i përngjit bukur duke i dhënë idesë një trup, mendimit - strukturë, ndjenjës - formë.

Në këtë fazë shndërrimi poeti nuk ka nevojë për formula apo disiplina shkencore, ai përdor në mënyrë spontane predispozicionin e tij natyror, atë aftësi që Zoti i ka dhuruar, si një e rënë shpatullave, lavdi që kthehet në përkëdhelje shpirtërore dhe bukuri njerëzore.

Në këtë dimension duhet të lexojmë dhe të çkodifikojmë artin poetik të Ilir Shaqirit, kompleks, heterogjen, shumëformësh, në ndjenja, në dashuri, në angazhimin shoqëror, në pjesëmarrjen aktive në komunitetin përkatës, në

pasionin për shqiptarinë globale, në adhurimin e pafund për popullsinë antike arbëreshe, në përvojat e jetuara, në sakrificat e një populli të lexueshme në lëkurën e tij, në heroizmin e njerëzve të thjeshtë luftëtarë të paepur për liri dhe të fortë si malet dardane, në këngët universale që ngritin moralin njerëzor dhe bëhen barriera të forta kundër prepotencës dhe barbarizmave.

I gjithë ky art është poezi e zemrës që lind nga zemra dhe i gjithë ... *universi flet me gjuhën e zemrës...*, i ndërgjegjshëm se... *mekanizmi i kohës nuk është ritmi i mendjes...*, poezi e një mendjeje të ndritur dhe të dashuruar me jetën, që përballon pa u dorëzuar kurrë, me durim, shpresë dhe fitore të një populli të martirizuar nga historia dhe lufta në të cilën... *njerëzit kishin harruar të qajnë, por jo edhe të këndojnë...*, poezia e vetëdijshmërisë që... *liria nuk bëhet me një gisht...*, e hapave të vështirë dhe e fitoreve guximtare.

Ilir Shaqiri është poet i dashurisë, i asaj ndjenje që zhvendos, ripërtërin idetë, që niset dhe kthehet, që ndërton e bashkon në gjallërinë e përqafimit.

*... Ngado shkoj...,  
prapë kthehem*

*çerdhe ku ndërtojnë  
zogjtë për çdo ditë -  
fole dashurie  
o këngë e shpirtit tim -  
qytet që t'pushton  
me një përqaqim!...*

Në harmoni të plotë me tokën dhe njerëzit që e rrethojnë, Ilir Shaqiri nuk ngjitet kurrë mbi një pedestal për të përshkruar botën, por zhytet në të, e jeton atë plotësisht dhe i jep ngjyra, duke u kthyer kështu në poetin e forcës, në atë mburojë që i tejkalon pengesat e dorëzimit, i vetëdijshëm që mëkati më i madh i njeriut është harrimi. Rrëfimi i udhëtimit në Arbëri, mes vëllezërve arbëreshë në Kalabri, sjell dhe përhap aromën e luleve të bajames deradiane si mesazh i një historie mrekullibërëse, i një natyre ripërtëritëse, i një dëshmie paqeje dhe shprese për të gjitha kombet e botës.

Ilir Shaqiri mbjell dhe mbledh nëpër arat më të thata, në fushat dhe malet më të ashpra, në erë, në ujëra, në rrëke, në shushurima e në heshtje. Dhe e gjithë natyra është e pranishme në këngë. Poeti përcjell dashuri dhe zhytet në të. Në poezinë më të famshme dhe më të shkurtër të Ungaretti-t “Mattina” (Mëngjes) poeti thotë

vetëm: *M'illumino d'immenso*. (Ndriçohem me pafundësi.) Domethënë krijimi zhytet te njeriu. Në poezinë e Leopardit “L’infinito” (Pafundësia) në vargjet mbyllëse: *Così tra questa Immensità s’annega il pensier mio: E il naufragar m’è dolce in questo mare*. (Kështu mes këtyre Pafundësive zhytet mendimi im:

Dhe përmbytja më vjen e ëmbël në këtë det), gjejmë njeriun që zhytet në pafundësi. Tek Ilir Shaqiri bashkëjetojnë të dy: pafundësia zhytet në të dhe ai vetë zhytet në pafundësi, noton me fuqi, mbijeton, lufton mes valëve armiqësore, duke e lënë veten të zhvendoset, të zhytet. Dhe kjo nuk është humbje, por pjesëmarrje, ashtu si këndonte kantautori italian Giorgio Gaber: *La libertà non è stare sopra un albero, non è neanche il volo di un moscone. La libertà non è uno spazio libero. Libertà è partecipazione!* (Liria nuk është tek të qëndruarit mbi një pemë, dhe as fluturimi i një mize. Liria nuk është një hapësirë e lirë. Liria është pjesëmarrje!)

Është pikërisht ky “deti i madh” i poetit Ilir Shaqiri, që kthehet në këtë mënyrë në një notar të aftë, kalon nëpër të shkuarën, kalëron të tashmen dhe projekton të ardhmen. Ai e di mirë atë çka thotë, çfarë bën dhe ku do të arrijë, pasi i

mbështetur nga një shoqëri që nuk lodhet kurrë, shpreson në një botë më të mirë, në një jetë më me dinjitet për të varfrit e për të shtypurit, i gjallëruar nga ideale të shëndetshme, të cilat e vënë njeriun në qendër të shoqërisë dhe në arritjen e fitoreve e të lumturisë. Për gjithë këtë Iliri mbetet i ri, revolucionar dhe paqësor. Dhe çdo keqardhje e tij është një arsye për të reflektuar. Çdo kujtim gdhendet në mendje, çdo humbje është një mundësi rifillimi. Të mos harrojmë një element të palëvizshëm, Ilir Shaqiri është një shkëmb i palëkundshëm, pilastër i vlerës etnike iliriane, i krenarisë së përkimit, i krenarisë që nuk fle kurrë, i kujtesës së një populli që nuk zhbëhet kurrë.

Ilir Shaqiri vëzhgon, nxjerr në pah, merr me vete, asimilon dhe rikthehet. Fjalët i bën tinguj dhe tingujt këndojnë, mjeshtëri parësore e një poeti, ku muzika dhe vargjet gërshetohen si aftësitë për të mbajtur kanistra e për të realizuar trupa. Dëgjon natyrën dhe përpunon heshtjet. Poeti nuk ka nevojë për shumë fjalë. Janë jonet komunikuese që jo përherë përkojnë ashtu si duhet me ndjesitë e duhura, me intimitetin; por megjithatë ai ndërhyr me eko të reja në një gjuhë që është në gjallërim të vazhdueshëm, rikuperon dhe riformulon fjalë, nxjerr në pah

klimën e fëmijërisë së hershme, rifiton efekte zanore të një shoqërie në zhvillim e sipër, të shpejtë dhe të pandalshme. Fiton kështu një raport të gjerë të shenjave gjuhësore, të cilat shpeshherë e lartësojnë dhe shpeshherë e mbajnë pezull pa shkaktuar asnjë tjetërsim nga realiteti.

Një poeteshë e madhe ruse, Marina Ivanovna Cvetaeva, ka thënë: *la poesia è qualcosa, o qualcuno, che dentro di noi vuole disperatamente essere.* (Poezia është diçka, apo dikush, që dëshiron dëshpërimisht të ekzistojë brenda nesh.)

Tek Ilir Shaqiri gjejmë këtë ekzistencë të poezisë dhe të qenët poet: vargje brilante dhe zërin që del vrullshëm nga indet e një kulture atavike, të veçantë dhe të papërsëritshme.

*Zef Kakoca*  
*Kalabri, 18 shtator, 2018*

*Shqipëroi dhe korrektoi - Aurora Kenga*

# I

*Çdo gjë e bukur ka diçka nga e kaluara!*





## THARM LIRIK

Si duket poezia  
në heshtje është lindur,  
në pamundësinë e saj  
që ta mbyll ndonjë brengë  
e kur fjala ngjyroset  
paksa me psherëtimë  
ajo merr krih,  
nis e bëhet këngë...

Si puhizë verore  
mbi krahët e një fluture  
situr përvetohet  
etshëm dashuria,  
përpushëm ngjyroset  
me ata sytë e tua  
hojëz - lirikë latore  
e venave të mia!  
Andej heshtje guri,  
këndej behje varri...,  
në mes nesh jeta e dashur,  
a thua të vdekur na shpalli?

Bëje shiun të këndojë  
pika-pika të na lajë,  
bëje agun të agojë  
fije-fije të na thajë.

Të na thajë e të na mbajë  
në një rreze të përthyer,  
derisa t'shpiket ndonjë mjet  
që këputë ëndrrën e pakryer...  
..., këndoje hënën të mos qajë  
bukuri e zënë me pajë...?!

Sonte kemi zjarr e mall,  
domosdo dhe pak trishtim,  
vesë vesuar nën qepallë  
pergamenë e ashtit tim!

ITH

Të mjegullt këta tinguj largësie,  
hakërrimthi zgjas duart drejt teje  
mbi të pakapërcyeshmen...

Ti je diku...?  
Ti që m'u bëre vetja  
dhe më mësove  
t'i kapërcej me dy hapa planetet...

Dua të më shfaqesh qartazi...  
T'i shoh sytë -  
buzëqeshjen,  
përplasjen që shkëndit  
në shpirt!  
Prekmë pakëz trupin e akullt  
që sonte "u dashka"  
të shkrihet ndryshe.

Dil nga mjegulla  
vetëm një çast,  
nxirrmë dhe mos më lerë  
në allçinë e kësaj nate  
të acartë?

Mos m'u humb, mos...?  
Dua të të shoh pashkëputshëm  
dhe asgjë tjetër...,  
dil nga e padukshmja,  
me ithin e dashurisë mbulomë,  
shpëtomë,  
së paku dy sytë e njomë?!

Idil e këngës së parë  
trupin të ma përshkojë,  
merrma dorën, prekmë...,  
që tjetërsimi të avullojë...  
Ah..., duart i tokim rrallë,  
shkurtazi e sa pak  
dhe më dukët se ngjitur jemi  
zjarreve të dashurisë  
diku këndeje, përqark!

Shkrumb u bëftë kjo natë...  
Nesër dua të stërditemi bashkë  
mu n'mes të universit!  
Lë të ngrohen planetet  
nga ithi i dashurisë sonë!

*Verë - vjeshtë, 2013*

## BJER O SHI

Nga e hëna në të hënë  
mëngjeset me shi...,  
ku mund ta kem harruar  
ombrellën e fundit,  
shpupuris në mendje, por...,  
nuk mund ta di.

Kësaj stine i humba shtatë...,  
ooo mendje e harrueshme  
gjethezverdhura e thatë,  
vjeshta vjen me shi  
e me shtrëngatë.

Në dyqanin përtej bulevardit  
ku shitet gjithçka,  
kërkoj një ombrellë?  
Shitësja më thotë: nuk ka,  
asnjë nuk ka mbetur...  
Sakaq para meje  
shtrin dorën  
një bukuri e rrallë  
paksa qerpikë fjetur.

Në dritarezën e dyqanit  
ajo derdh dy pare...

- Kujdes, i tha shitësja,

- prit radhën,

duhet pak mirësjellje,

apo nuk sheh fare?

Më pa qerpikëfjetura

me ata sy të thellë...

- S'ju them tungjatjeta,

u përgjigj ajo,

- burrave pa ombrellë,

qullen nëpër shi

e mendja çfarë s'u pjell!

Mori çfarë iu desh,

ktheu kokën mënjanë,

flokët i rrëzoi mbi shpinë,

o Zot..., ku do t'ndalet,

ku e ka shtëpinë?

Seç më erdhi në mendje  
ajo e moçmjja këngë:  
*Flokët e zeza t'i qes përmbi,  
lagët dada e s'lagesh ti!*

Dhe, e mori urbani  
flokëzezën,  
flokëshpeshtë,  
që s'përfillte shiun  
as pritjen në rresht.

Bash si një gjethe vjeshte  
u humba pa uzdajë,  
duke pëshpëritur nga brenda:  
Lum ai që i ka ombrellë  
flokët e saj!

## NDJEKJE YJESH

Hapësira mes nesh  
netëve na mban zgjuar,  
ndjekja nëpër qiell  
përbën mrekullinë  
e për ta rimarrë  
një lajm të gëzuar  
duhet shkundur kokën  
së paku një grimë.

Mekanizmi i kohës  
nuk është ritmi i mendjes,  
ndjenja e së pamundurës  
na mahnit gjithmonë,  
universi flet  
me gjuhën e zemrës,  
gjithçka kem rreth vetes,  
gjithçka na mungon.  
Prandaj, kurrë skam dashur  
të të quaj yll,  
sepse yjet ndiqen  
qiejve pa u takuar,



më mirë të të quaj  
drenushë nëpër pyll,  
që të mund të të zë  
e të mbaj me këto duar!

Mbetem kureshtarë  
me pasione të mëdha,  
ëndrrat e dritësuara  
kurrë të mos i fikim  
se dhe universi  
kode të fshehta ka,  
nga qielli vijmë  
e andej do të ikim!

## ATELIE

Kur të jesh pak e mërziur,  
mallëngjyer kur të jesh  
trokit pak te zemra ime  
të pret shtrati ku do flesh.

E të flesh e të zgjohesh  
flokëshprishur pa nënkresë,  
me astar të hollë mëndafshi  
si një lule larë me vesë.

Si një lule larë me rreze  
e përkryer me ato linja,  
mes dritëhijesh trumza-trumza  
përgjërohen shtatë palë thinja.

Kur ma shfaqë kutinë e llërit  
istë mes detesh bukurie,  
drizash dridhem i drobitur  
si një gjeth në prag stuhie.

Si një gjeth fërfëllhem  
në sytë e tu melankolik,  
kur i ngre ato qepalla  
shfaqet bota nën qerpikë.

Shfaqet bota, bukuria,  
shkrihet dielli mbi një mal,  
në atelienë e zemrës sime  
do ta ngre një Taxh Mahal!

Në Kopsht Edeni e pjalmuar,  
pjalm lirikash m'i fryn dejtë  
si te libri i pambaruar  
i Ernest Heminguejt!

E ta kthejmë kohën e gjallë,  
kohë stinore e pakthyer  
t'i bëjmë vitet palë e palë  
te piktura e pakryer.

Te piktura lënë përgjysmë  
lagëtyrë indesh e një bote,  
i krezmuar fije-fije  
mot e sot nga hija jote.

Hija jote vlagë Strigari,  
kungatë kupash nëpër mote  
e unë mbeta në mostjetër  
gur që s'del nga hija jote.

Në algjebrën e mendjes sime  
hazëroj t'i bëj hesap  
ato muzgje perëndimesh  
që na ikën aq me vrap.

Do të vish moj, do të vish  
dhe së fundmi të më gjesh  
në atelienë të zemrës sime  
shtrova shtratin ku do flesh!  
Do t'u them në krye t'udhës  
gjitonisë që shprehet ndryshe:  
s'është mëkat që n'gji t'gjethrënit  
çerdhe bën një dallëndyshe.

Rastësisht këto fjalët e mia  
për çfarëdo të bien ndesh,  
lë t'më marrin, lë t'më djegin  
si t'pauhin m'u në shesh.

Hiri im do thërras më zë:  
hirplote..., ku do jesh,  
përtej botëve në krahë fluturash  
shtrat t'u bëfsha ku do flesh!

NGA DITARI I NËNËS  
(1967)

Nga furka që nxirrje  
atë fije të pakëputur shprese  
më vjen sot  
sikur ajo fjalia e gjatë  
e shkrimtarëve të regjur,  
që zgjerojnë qëndismën  
nëpër hone kujtese  
të përbërë e të përkryer  
me sa e sa pikëpresje...

E jotja,  
në atë fillin e gjatë  
vihej veç atëherë  
kur njomje dy gishtat  
në buzën e thatë!

Vjegëza nyjëzohej në fund  
kur gjeli zgjonte një katund!

Një lëmsh fije pakëputur  
po aq sa një glob plastike,  
që na e sillte  
mësuesi i gjeografisë në klasë  
dhe shtyheshim  
e shqyheshim  
kush i pari ta prekë,  
kush i pari ta kapë?!

Ndryshimi ishte se  
globi i mësuesit nuk xvillohej  
siç xvillohej lëmshi yt fijeleshtë  
për të na thurur çorapë.

Sa ëndrra, kujtime e dëshira  
tirreshin e lumnoheshin aty?!

Opingat nuk ishin nga viset tona,  
na lëshonin ujë,  
baltë e borë,  
ti mbeteshe mbrëmjeve te kroi  
duke na i larë me dorë,  
pranë vatrës duke na i tharë  
me mund  
e me zor.

Dhe nuk ishin pak:  
tetë palë opinga  
e tetë palë çorapë  
për shtatë djem  
e një çikë  
dhe kurrë s'ta pamë  
lodhjen as gjumin  
nën qerpikë.

Na rendisje rreth sofrës  
dhe qëndroje në këmbë  
duart në bel mbështetur,  
ndoshta ky ishte  
i vetmi çast pushimi  
për ty, sypafjetur.  
Nga duart tua të bardha  
hanim bukën e ngrohtë  
e nga ti mbanim vesh:  
të ngrihesh nga sofrë  
ngopur duhet të jesh?!

E ne të përgjigjeshim  
radhazi  
sikur tetë nota  
shëndetplota...,  
polifoni gëzimi,  
harlisje mes nesh,  
lagjja mund të mendonte  
se në odën tonë  
po mësohej solfezh!

E para gjë që na mësove ishte:  
që gjithkush ta lajë pjetën e vet,  
në mos kush do harronte  
me grushte do ta hante të nesërmen  
groshën e nxehtë.

Mëngjeseve  
këmbëngrohët  
niseshim për në shkollë  
me porosinë tënde  
tjerrur hollë:

*Gjithçka bëhet me diçka e për diçka!*



Të falem nënë!

O shtrenjta ime -  
e shenjta vlerë,  
nuk di a ke fjetur  
siç duhet  
ndonjëherë?

U bëmë të lidhnim duaj  
e të bënim kryza,  
domosdo kositjen  
dikush duhej ta mësojë?!  
Vendimi ishte i yti  
tek drejtove gishtin  
nga yt bir i madhi,  
me atë buzëqeshje hyjnore:  
do pak art kosa e livadhi!

Vetëm të thurnim gardhe  
kurrë nuk na mësove...,  
e kjo nga mendja nuk më hiqet:  
ndër të parat gjëra  
që bota s'ka nevojë për to,  
thoshe, janë gardhiqet!

*Stuhive u duhen ballët, jo gardhet!*

Sikur *Sitthatra*, kur mësoi  
se si akordohet një tel,  
që nxjerr tinguj shprese  
nga ato që jeta sjell,  
u bëra ta kuptojë  
filozofinë tënde  
o nënë,  
që na lave e shpërlave  
me diell e me hënë!  
Dhe më zgjon kujtime  
ajo kohë  
jo shumë e lashtë  
ku nënkresa kishim  
jastëkët me kashtë,  
po e po çorapët e leshta  
*Made in Kosova, 1967.*

## MELODIA E SYVE

Sa herë...,  
më është këputur frymëmarrja  
nga shikimi yt,  
nga buzëqeshja jote -  
valë e valëzuar,  
udhë e trëndafiltë  
zemrës -  
bleruar...

Ti mbete strofa e parë  
e një kënge të bukur  
që tringëllon,  
troketë,  
refreni këndohet ende  
brenda nesh -  
zëshëm  
në duet...!  
Një herë u zura në gabim,  
pyeta veten:  
pse kaq shumë të dua?  
Përgjigjja ishte aty  
e menjëhershme  
e brendshme  
e pazëshme,  
arsye e përjetshme -  
melodia e syve tua!

## OJTNITË E BABAIT

Verë o verë, o e paverë,  
syri i diellit n'dysh i prerë,  
gjysma terr - zi e brengë,  
gjysma tjetër nëpër këngë!

Duke lidhur këpucët për në punë,  
mëngjeset i bënte të këndueshme:

*N'terr të zi vera ka shkue,  
thujmi vashës ke gabue...,  
thujmi vashës, mos ke gabue...?*

Nëna qëndronte në derë,  
duke e përcjell  
me sytë e zemrës:  
*Ta bëftë Zoti verë!*  
E kur kthehej vonë nga puna  
n'dritë kandili shqyhej terri,  
kënga vlonte nga përbrenda:  
*Prej Podrimës po vjen haberi...*

Ishte kohë e lajmeve të zymta  
e fëmijët nuk duhet t'i mësonin ato.

Kur na mblidhte nën një hije  
kuvendonte hollë e hollë,  
nuk harronte të na thoshte:  
Kam një arë dhe një bahçe,  
një oborr të mbjell me mollë,  
mos më rëntë dielli n'faqe  
po s'i shita që t'nxëni shkollë!

Përsëritja na e mësonte jetën!

Dhe u rritëm duke nxënë,  
fjala e tij na trokiste...,  
e kur mbeteshim të pangrënë  
prapë një xixë në shpirt na ndriste  
sepse halli s' duhej thënë,  
arën, bahçen të mos i shiste!

Dhe nuk ndalej kënga e verës:  
*N'terr të zi vera ka shkue,*  
*thujmi vashës...*

Derisa nëna iu përgjigj një ditë:  
*shtina menën me menue...,*  
*kush'a vasha që ka gabue?*

Pasi lidhi këpucët u ngrit në këmbë  
dhe e mori në përqaftim:

*Ë..., moj grue, si thue?*

Nëna iu përgjigj, buzëqeshur:

*Besa..., hiq s'ka gabue!*

*Epo, s'ke ku gjenë arshik si mue...!*

Edhe atë mëngjes u përshëndetën

pa pendim,

me ngrohtësinë e copës së diellit

që u takonte!

## II

*Kur ndjenjat nxiten  
nga reflekse të çiltra dashurie,  
ato të veshin me dritë  
dhe të bëjnë të vallëzosh hijshëm  
edhe aty ku breshërojnë  
e të këpusin stuhitë!*





## PARANDJENJË ORFEIKE

*Muzika është fenomen i natyrës psikologjike me rëndësi të madhe njerëzore, si shprehje e caktuar e vetëdijes estetike të njeriut dhe objekt i qëllimeve morale e sociale të tij.*

Fundi i vitit 1983, më gjeti në Shtëpinë e Kulturës “Hasan Prishtina” në Drenicë, duke nisur punën me Ansamblin folklorik me të njëjtin emër, që do të funksiononte nën ombrellën e SHKA “Drenica”, bashkë me trupën e teatrit dhe një orkestër tjetër që nga anëtarët e saj quhej “G-dur”.

Në ushtrimoren e paracaktuar nga BVI për kulturë kishin arritur të gjithë pjesëmarrësit që paraprakisht kishin fituar audicionin e zhvilluar dy javë më parë në këto ambiente. Edhe instrumentet muzikore kishin arritur (flakë të reja): tridhjetë e tri çifteli, dy sharki, dy daulle e tri dajre, të mjaftueshme për një ansambël që do të përpiqej t’i ngjante kohës.

Instrumentistët e rinj i morën në duar instrumentet e reja, duke shqyrtuar ndërtimin artizanal, përbërjen drunore dhe aftësitë e tyre tingullore.

Një trokitje në derë ndërpreu për një çast komunikimet tona. Aty u shfaq një burrë rreth të shtatëdhjetave.

- Isha në barnatore me këto dy receta që të merrja ilaçe për plakën time, por, më thanë së nuk ka..., mora vesh se je këtu e erdha.

I pashë recetat e dy ilaçeve të cilat mungonin shpesh në të gjitha barnatoret e Kosovës. Bashkë me shtatëdhjetëvjeçarim shkua në zyrën e barnatores dhe përmes telefonit po komunikojta me kolegun tim farmacist Ilmi Pulaj, që punonte në objektin e grumbullimit të barnave "Farmed" në Prishtinë, i cili më garantojti së nesër në mesditë këto dy barna të munguara do të jenë në Drenicë. Plaku e dëgjojti të gjithë bisedën që pata me Prishtinën dhe pasi e mbylla telefonin ai hoqi plisin ngadalë, nxori shaminë që e mbante në xhep, duke fshirë ballin e qafën nga djersët, më tha:

- Edhe unë e kam në shtëpi një çifteli..., e mbaj aty dhe ia shkund telat vetëm kur vjen ndonjë mysafir. Po ta sjell nesër?..., - më shumë u duhet juve sesa mua, më tha.

- Faleminderit, - i thashë, - tashmë jemi të kompletuar si ansambël; e rëndësishme është, me ato që kemi të bëjmë këngë të bukura.

Ia dhashë dorën për përshëndetje, duke ia kujtuar se të nesërmen në mesditë duhet të vinte deri në barnatore për t'i marrë barnat. Ai nuk ma lëshonte dorën, duke insistuar:

- Çiftelia ime është e punuar nga druri i manit, kushdo që e ka pasur në dorë është mahnitur nga tingulli i bukur i saj.

- Le ta gëzojnë e trashëgojnë nipërit e mbesat tuaja! - i thashë..., - çiftelia i jep hijeshi çdo ode, apo jo?

U ktheva në ushtrimoren e ansamblit dhe pashë një burrë rreth të tridhjetave që kishte zënë vend, me sharki në duar, në mes të anëtarëve të ansamblit dhe po u fliste atyre. Nga pamja dukej shumë i rregullt, i thellë dukej nga shikimi dhe tepër i urtë nga komunikimi. Pas çdo fjalie të zgjeruar e fraze mendimesh të latuara, me dy gishtërinjtë e dorës së djathtë përshkonte mustaqet e tij, që ia shtonin vitet e djalërisë. Ai fliste për përbërjen drunore të instrumenteve tona të reja dhe lavdëronte drurin e manit.

- Qenka mjeshtër ai që i ka punuar këto kupa çiftelish me dru mani, sepse kumbimi i tingujve do të dalë më i pastër. Kapakët i paska bërë me

urëz pishe, ndërsa bishtat me dru qershie. Vetëm mjeshtrit që e njohin mirë natyrën, e përdorin drurin e qershisë për punimin e objekteve të tyre, sepse koha, e ardhmja i bën edhe më të bukura këto instrumente, shpjegonte ai.

Pasi mbaroi ligjërimin, la sharkinë mënjanë dhe bëri të ngrihej nga vendi ku ishte ulur.

- Ua mora kohën, burra..., por, u gëzova shumë që po filloni punën, prandaj erdha t'ju uroj me gjithë zemër!

- Ty Zoti të gëzoftë!, i thashë, - por gëzimi ynë do të jetë i plotë nëse atë sharki nuk do ta lëshosh nga dora, këtu në mes të këtyre të rinjve të talentuar, natyrisht pa e penguar punën tënde prej aktori në trupën e teatrit. Figura jote do të na shërbejë pamatshëm në udhën e nisur.

Dhe ashtu ndodhi, Hamëz Jashari zuri vend në zemër të ansamblit “Drenica”.

Ditëve në vazhdim po shqyrtonim repertorin e këngëve që duhet t'i bënim gati për koncertet që na prisnin. Njëra nga këngët nuk na funksiononte siç duhej, sepse çiftelive u mungonin dy gjysmë nota, nga ato të domosdoshmet me të cilat ishte ndërtuar kënga dhe ishte interpretuar nga formacioni i Orkestrës së Ansamblit të Këngëve dhe Valleve të Shqipërisë.

Përpjekja e instrumentistëve për të bërë një zgjidhje ishte e kotë, ndërsa dëshira për ta interpretuar këtë këngë ishte e madhe.

Kisha lexuar diku, se kohë pas kohe, në muzikën popullore futën nuanca të reja tingullore, figura të reja ritmike, forma që afrohen me muzikën e kultivar, por intonacionet dhe elementet e reja muzikore nuk përfshihen brenda muzikës folklorike, nëse s'janë të pranueshme për ndërgjegjen dhe shijen estetike muzikore të artistëve popullorë. Se çfarë elementësh të rinj mund të hyjnë në to, kjo përcaktohet nga kriteri i përzgjedhjes estetike në procesin objektiv të tyre.

Nga shkopinjtë e vegjël me kokë të kuqe të një shkrepëseje, formësuam gjysmë notat në bishtat e çiftelive, duke i ngjitur ato me një ngjitës të thjeshtë, sa për ta provuar mbarëvajtjen e melodisë së këngës. Dhe funksionoi! Të nesërmen të gjitha çiftelitë i ngarkuam në makinën *Opel 16* të Hamzës dhe ia dërguam mjeshtrit Sylë Kurti nga Vushtrria për t'i vendosur gjysmë notat e shenjëzuara paraprakisht nga anëtarët e orkestrës së ansamblit. Pas një jave gjithçka ishte gati dhe vazhduam provat deri në koncertin që do të shfaqnim para publikut.

E bukur ndër më të bukurat, e pëlqyer ndër më të pëlqyerat na doli kënga, për shkak të së cilës i bëmë ato ndryshime në çifteli.

Pas dy ditësh në gazetën “Rilindja” të kohës, doli një artikull që na gjykonte ashpër për ndërhyrjet tona në instrumentet e traditës. Artikulli ishte shkruar goxha me kompetencë profesionale nga një etnomuzikolog. Në fytyrat e anëtarëve të ansamblit dukej shqetësimi nga ky artikull, por jo edhe në portretin e Hamzës, i cili po numëronte telat e sharkisë dhe u tregonte të rinjve se ky instrument mund të jetë me pesë, me shtatë, me nëntë e dymbëdhjetë tela, varësisht nga mjeshtri që e zotëron atë.

Seç më erdhi në mendje figura mitologjike e Orfeut, që lirës së tij, nga shtatë tela ia shtoi edhe dy të tjerë dhe e bëri atë me nëntë.

Motivi i Orfeut, në krijimtarinë tonë gojore, rrjedh si një burim kroi i pastër, i çiltër e lotues; me forca të mbinatyrshme të mrekullueshme, përmes joneve magjike të zërave, këngëve dhe instrumenteve të panumërta burimore.

Në historinë tonë muzikore këngët e krijuara nga artisti popullor jo gjithmonë e kanë ruajtur thjeshtësinë e simotrave të veta në rrafshin tingullor. Edhe zhvillimi i polifonisë labe ka përkshuar rrugë të ndërlikuara në harmonizimin

e nuancave, ku gjithsesi, lënda muzikore na paraqitet më e zhvilluar. Krijimet e reja duhet të jenë edhe më të pasura në këtë rrafsh, prandaj na duhen instrumente që na e japin këto mundësi shtesë. Këto nuk mund të mos ua thosha anëtarëve të ansamblit, në mënyrë që ta zbusja sadopak shqetësimin e tyre.

- Këtë këngë nuk mund ta heqim nga repertori ynë dhe për pasojë, ne do t'i mbajmë perdet që ua kemi shtuar çiftelive, sepse të tjera këngë si kjo, të krijuara e të përpunuara do të vijjnë në vazhdimësi të punës sonë në këtë ansambël, tha Hamëza.

Tri trokitje të buta na e këputën kuvendimin tonë për një çast. Në derë u shfaq plaku shtatëdhjetëvjeçar, jo më me receta në dorë siç pat ardhur para tre muajve, por me çiftelinë e tij të punuar nga druri i manit.

- Erdha t'ju shoh..., e me m'ja shtue nja dy perde kësaj të shkrete..., nuk më del ajo kënga juaj e mirë që e kënduat në koncert!

U habitëm të gjithë, derisa e pyeta:

cila ishte ajo këngë, o mixhë?

- Diçka me malin bënte fjalë, u përgjigj ai.

- E po s'rrafshohet mali pa mjete, i thashë me buzëqeshje.

- Pa mjete e pa dashni, ndërhyri Hamëza.

Derisa udhëheqësi i orkestrës po ia vijëzonte dy shenja për t'i vendosur perdet e reja në çiftelinë e tij, zura ta pyes për shëndetin e gruas?

- Paj..., ju po na shnoshni me shumëçka, u përgjigj me dashamirësi e mirënjohje.

- Mosdorëzimi është bukuria e jetës, iu drejtua Hamëza të rinjve të ansamblit dhe vazhdoi: i vetmi rast që duhet të na e kthejë kokën pas është historia, jo që të mbesim aty në të njëjtat kondita, por që ta mësojmë mirë atë, në mënyrë që të jemi të gatshëm ta përballojmë të sotmen e ta fitojmë të ardhmen!

Shtatëdhjetëvjeçari mori çiftelinë e tij në duar, tashmë të vijëzuar me dy perde shtesë dhe duke na përshëndetur të gjithëve përqafozi, - na tha:

Tri gjëra e hijeshojnë botën: Zoti n'qiell, liria e dashnia n'tokë!

- Zoti na sheh më mirë nëse dashnia mes nesh rritet fort dhe tek atëherë do të jemi gati ta përqafojmë të paftuarën tonë të cilën duhet ta fitojmë me çdo kusht, tha Hamëza.

Ligjërime të këtilla dhe të tjera si këto ngjanin me motivin e Orfeut, me të jetuarit simbolik të tij edhe përtej vdekjes, koncept i lashtë mitik e tragjik, që në kuptimësinë e krijimtarisë sonë gojore, në përfytyrimin popullor shfaqet si trinom: jetë-vdekje-pavdekësi.



## PARANDJENJË E PASTËR

Dy perde më shumë  
në qafën e çiftelisë  
për hatër të një kënge  
që s'këndohej ndryshe,  
fundshekulli i shpërfilljes,  
apo i risisë,  
Zeusi mungonte,  
Hadi me mëdyshje.

S'na duhen ndërmjetëzat,  
asgjë tjetër shtesë,  
këngëve të mallëngjyeshme  
s'iu duhet maxhor,  
dërdëllisnin trutharët  
zëshëm, pa pendesë  
Ministrat e Ferrit  
dhe ca shërbëtorë.  
Edhe Prometeu  
shpërfillur na shihte,  
rebelimin tonë  
nuk e miratonte,

përveç Apollonit  
që me zell na ndiqte,  
derisa kënga bëri krahë  
të fluturonte!

Sa e depërtueshme  
vinte kjo muzikë  
nga dy nota të reja  
në një degë qershie,  
në buzët tona të çara  
këngë dhe pak frikë,  
parandjenjë e pastër -  
drithërimë dashurie!

Risi e fundshekullit  
muza jonë e re,  
sikur një lugë ajkë  
në korën e bukës,  
kundraorfeianët  
me britma pa fre:  
këto gjëra i zgjidh  
vetëm hyji i luftës.